



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr.107/2016

PËR PREFEKTIN E QARKUT

*Shënim:
Teksi me ngjyrë të kuqe,
paraqet ndryshimet me
ligjin NR. 107/2016,
date 18.04.2024.*

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 114, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rolit të prefektit të qarkut, misionit të tij dhe kompetencave në përmbushje të detyrave të tij, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave, në nivel qarku.

Neni 2
Objekti

Ky ligj rregullon marrëdhëniet e prefektit të qarkut me organet dhe institucionet e administratës shtetërore, me organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore, degët territoriale që veprojnë në qark dhe me institucione të tjera shtetërore.

Neni 3
Misioni

Misioni i prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore .

2. “Degët territoriale” janë strukturat administrative të një ministrie ose të një institucioni të varësisë, që krijohen për të ushtruar në territorin e një ose më shumë njësisë të vetëqeverisjes vendore detyra administrative, që mund të kryhen më mirë në territor, në përputhje me parimet e ligjit për

organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

3. “Institucione të tjera shtetërore” janë institucionet dhe strukturat e Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të organeve të tjera në rastet e parashikuara shprehimisht me ligj, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative.

4. “Ministri” është ministri përgjegjës për veprimtarinë e prefektit të qarkut.

Neni 5

Emërimi dhe lirimi i prefektit

Prefekti i qarkut emërohet dhe lirohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 6

Kriteret e emërimit

Për të ushtruar detyrën e prefektit të qarkut, shtetasi duhet të plotësojë këto kriteret:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare, me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi;
- c) të ketë 5 vjet përvojë pune në administratën publike;
- ç) të mos jetë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë veprë penale, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- d)) të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi, si dhe të mos i jetë hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni.

Neni 7

Papajtueshmëria e funksionit

1. Prefekti i qarkut nuk mund të jetë anëtar i Këshillit të Ministrave.
2. Funksioni i prefektit të qarkut është i papajtueshëm me çdo mandat zgjedhor e me çdo funksion tjetër publik, me përjashtim të mësimdhënies me kohë të pjesshme dhe të veprimtarive shkencore.
3. Prefekti i qarkut nuk mund të jetë drejtues në organizatat fitimprurëse ose anëtar i organeve drejtuese në një shoqëri tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse, kur këto ushtrojnë veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit administrativ të prefektit të qarkut, me përjashtim të pjesëmarrjes në parti të politike ose të pjesëmarrjes në këto organe, për shkak të funksionit.
4. Prefekti i qarkut nuk mund të ushtrojë profesionin e avokatit, noterit, ekspertit të licencuar, konsulentit, agentit, përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni.
5. Prefekti i qarkut nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit administrativ të prefektit të qarkut.

Neni 8

Përgjegjësitë kryesore të prefektit të qarkut

Në ushtrim të funksionit të tij, prefekti i qarkut ka këto përgjegjësi kryesore:

- a) verifikimin e ligjshmërisë së **akteve** me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore;
- b) bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet degëve territoriale, që veprojnë në qark si dhe të këtyre degëve me organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore;
- c) raportimin periodik në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e degëve territoriale që veprojnë në qark, sipas urdhrit të Kryeministrit, dhe, për probleme të veçanta, sipas urdhrit të ministrit;

ç) informimin çdo gjashtë muaj të institucioneve qendrore për veprimtarinë e strukturave të tyre të varësisë, në nivel qarku;

d) nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve e të veprimtarive me institucionet homologe sipas marrëveshjeve përkatëse;

dh) drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile;

e) drejtimin e task-forcave, krijimin e organizmave të përkohshëm, të komiteteve, të grupeve të punës dhe të komisioneve për çështje të caktuara;

ë) drejtimin ose pjesëmarrjen në ceremonitë zyrtare shtetërore që zhvillohen në nivel qarku, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

f) forcimin e kapaciteteve institucionale në zbatim të programeve të buxhetit të shtetit;

g) kontrollin dhe monitorimin e zbatimit, në nivel qarku, të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë;

gj) bashkërendimin e veprimtarisë së tij me agjencitë dhe inspektoratet që veprojnë në nivel qarku, si dhe monitorimin e veprimtarisë së tyre. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin me drejtuesit e këtyre institucioneve, prefekti i drejtohet ministrit përgjegjës;

h) shqyrtimin çdo muaj të veprimtarisë së degëve territoriale që veprojnë në qark dhe bashkërendimin e punës ndërmjet tyre dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të programit të Këshillit të Ministrave;

i) bashkërendimin e punës me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe struktura të tjera zgjedhore vendore, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor;

j) ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të tjera që ingarkohen me akte ligjore ose nënligjore.

I) përcjelljen e kërkesës së arsyetuar për fillimin e inspektimit pranë institucioneve të ngarkuara me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit;

II) ndërmarrjen e nismave dhe propozimeve për dhënien e titujve të nderit për persona me kontribut të veçantë në qark, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU II

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN SHTETËRORE

Neni 9

Marrëdhëniet e prefektit të qarkut me Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore

1. Prefekti i qarkut për veprimtarinë e vet përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave, Kryeministrit dhe ministrit.

2. Këshilli i Ministrave, ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore i dërgojnë prefektit aktet e nxjerra, në të cilat caktohen detyra apo përcaktohen marrëdhënie në fushën e veprimtarisë së degës territoriale që vepron në qark.

3. Prefekti i qarkut, për veprimtarinë që mbulon, mund të propozojë pranë ministrive projektakte për zgjidhjen e problemeve të veprimtarisë së tyre.

4. Konfliktet që mund të lindin ndërmjet ministrave dhe prefektit zgjidhen nga Kryeministri.

Neni 10

Marrëdhëniet e prefektit të qarkut me degët territoriale

1. Për kryerjen e funksioneve në marrëdhënie me degët territoriale që veprojnë në qark, prefekti i qarkut ushtron përgjegjësitë e mëposhtme, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj:

a) kontrollon dhe kërkon marrjen e masave për zbatimin e programit të qeverisë, për ushtrimin e funksioneve dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e degës përkatëse;

b) kërkon hartimin e planeve të zhvillimit dhe të projektbuxhetit vjetor, sipas procedurave të përcaktuara me ligj dhe u paraqet mendimet e tij ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore;

c) ndjek kërkesat dhe ankesat e shtetasve deri në zgjidhjen e tyre;

ç) kërkon të dhëna dhe informacione nga dega territoriale që vepron në qark, me përjashtim të rasteve kur ndalohet me ligj ose me akte nënligjore, për shkak të klasifikimit të informacionit të kërkuar. Degët territoriale që veprojnë në qark informojnë prefektin e qarkut për çështje, për të cilat kërkohet informacion;

d) harton çdo fund viti raportin mbi bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë me degët territoriale që veprojnë në qark, dhe ua paraqet ministrive përgjegjëse dhe Kryeministrin.

2. Degët territoriale që veprojnë në qark dërgojnë kopje të planit të zhvillimit, të projektbuxhetit, të strukturës dhe të organikës te prefekti i qarkut.

3. Në rast të ndryshimeve strukturore të degëve territoriale apo drejtorive të ministrive në qark, ndryshimet i bëhen me dije prefektit të qarkut.

Neni 11

Propozimet për emërim dhe lirim të drejtuesve të degëve territoriale

1. Emërimi dhe lirimi nga detyra i drejtuesve të degëve territoriale që veprojnë në qark bëhen në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me propozim të prefektit të qarkut, përveç rasteve kur ligji i posaçëm që rregullon marrëdhëniet e punës apo mënyrën e emërimit dhe të lirimimit të tyre, e parashikon ndryshe.

2. Prefekti i qarkut i propozon ministrin përgjegjës ose drejtuesit të institucionit qendror përkatës emërimin ose lirimin e drejtuesit të degës territoriale që vepron në qark.

3. Propozimet për emërim duhet të bëhen me jo më pak se dy kandidatura.

4. Ministri përgjegjës ose titullari i institucionit qendror kthen përgjigje brenda 15 ditëve nga data e marrjes së propozimit. Në rast moskthimi të përgjigjes apo refuzimit të propozimit, prefekti i qarkut informon Kryeministrin.

Neni 12

Detyra në lidhje me organet e Policisë së Shtetit

1. Prefekti i qarkut bashkëpunon me organet e Policisë së Shtetit për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, në nivelqarku.

2. Prefekti i qarkut kërkon zbatimin e masave për ruajtjen e rendit, sipas përgjegjësiave dhe detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore.

3. Prefekti i qarkut kërkon dhe merr rregullisht informacion nga drejtori i policisë vendore për problemet e rendit.

4. Prefekti i qarkut bashkërendon veprimtarinë dhe siguron mbështetjen e ndërsjellë të organeve të Policisë së Shtetit, të degëve territoriale që veprojnë në qark dhe të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Neni 12/1

Këshillat vendorë të sigurisë publike

1. Me propozimin e prefektit të qarkut pranë njësive të vetëqeverisjes vendore ngrihen këshillat vendorë të sigurisë publike (KVSP) për identifikimin e problematikave për rendin dhe sigurinë publike në komunitet.

2. Për shqyrtimin e problematikave për sigurinë publike në komunitet, të identifikuara nga KVSP-ja, krijohet dhe funksionon Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet (KKSK).

3. Përbërja, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike (KVSP) dhe të Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet (KKSK) përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Detyrat për mbrojtjen civile

1. Në raste të veçanta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile, prefekti i drejtohet ministrit përgjegjës për Mbrojtjen për angazhimin e njësive të Forcave të Armatosura dhe kërkon mbështetje për përballimin e detyrave me karakter civil dhe në veçanti në përballimin e situatave të emergjencave civile e të krizave.

2. Prefekti i qarkut i kërkon mbështetje Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sipas kërkesës së bërë nga bashkitë.

3. Prefekti i qarkut koordinon në nivel qarku veprimet në terren të njësive të Forcave të Armatosura, të cilat angazhohen bazuar në deklaratimet në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, me qëllim realizimin e detyrave me karakter civil, që u ngarkohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile.

Neni 14

Propozimi dhe drejtimi i task-forcave dhe organizmave të përkohshëm

1. Prefekti i qarkut drejton task-forcat e ngritura me akte ligjore e nënligjore dhe është përgjegjës për performancën e tyre, në nivel qarku.

2. Në çdo rast, kur në përbërje të task-forcave ka njësi të Forcave të Armatosura, ato drejtohen nga autoritetet ushtarake nëpërmjet zinxhirit të drejtimit e të komandimit, sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacionit të shpëtimit.

3. Prefekti i qarkut i propozon Kryeministrit dhe ministrit ngritjen e task-forcave dhe krijon organizma të përkohshëm në raste të veçanta, në nivel qarku.

4. Drejtuesit e degëve territoriale që veprojnë në qark dhe kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore, kur janë anëtarë të një task-force, kanë detyrimin të marrin pjesë dhe të zbatojnë detyrat e caktuara për këtë task-forcë, në zbatim të këtijligji.

KREU III

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ORGANET E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 15

Marrëdhëniet e prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore

1. Ndërmjet prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore nuk ka marrëdhënie varësie.

2. Marrëdhëniet ndërmjet prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore bazohen në parimin e konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

3. Marrëdhëniet midis prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore përcaktohen në këtë ligj dhe në ligjin për vetëqeverisjen vendore.

Neni 16

Verifikimi i ligjshmërisë së akteve

1. Zbatimi i akteve të organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore bëhet në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin për vetëqeverisjen vendore.

2. **Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e mëposhtme:**

a) çdo organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i detyruar të depozitojë te prefekti i qarkut të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre. Marrja dijeni nga prefekti i qarkut për aktin e depozituar nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e tij në zyrën e protokollit të prefektit;

Aktet me karakter normativ shoqërohen me një relacion përmbledhës të arsyeve për nxjerrjen e tyre, duke argumentuar për problematikat, qëllimet, objektivat që synohen të arrihen, përparësitë, si dhe efektet e pritshme nga miratimi.

b) për çdo akt të regjistruar në zyrën e protokollit, prefekti i qarkut detyrohet të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, sipas procedurave të mëposhtme:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t'ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

ii) vendimi i marrë nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, depozitohet pranë prefektit të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës "a", të kësaj pike;

iii) në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, prefekti i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës është organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar deklarin e pavlefshëm të këtij akti. Prefekti i qarkut ka të drejtën e kthimit vetëm një herë të një akti;

iv) në rastet kur vëren shkelje ligjore në akt dhe vlerëson se kthimi i aktit nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, prefektit i lind e drejta që, pa ndjekur procedurën e përcaktuar në shkronjën "b", nënparagrafi "i", të kësaj pike, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kur kërkon pavlefshmërinë e aktit në gjykatë, prefekti i qarkut njofton organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 17

Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve

1. Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur nuk përcaktohet ndryshe në akte të tjera ligjore, jo më pak se një herë në 3 muaj.

2. Në rast se gjatë verifikimit në vend të ligjshmërisë prefekti i qarkut konstaton akte, të cilat nuk janë depozituar tek ai, sipas procedurës së parashikuar në nenin 16, të këtij ligji, kërkon pavlefshmërinë e tyre në gjykatën kompetente për çështjet administrative.

Neni 18

Verifikimi i përgjegjësive të deleguara

1. Prefekti i qarkut verifikon realizimin e funksioneve e të përgjegjësive të deleguara nga pushteti

qendror dhe përdorimin e fondeve të parashikuara për këto funksione.

2. Prefekti i qarkut verifikon përdorimin e fondeve, donacioneve apo kredive që rrjedhin nga marrëveshje të qeverisë me organizma ndërkombëtarë.

3. Në rast se gjatë verifikimit konstatohen shkelje ligjore, prefekti i qarkut informon ministrin, ministrin përgjegjës të funksioneve të deleguara, si dhe Kryeministrin, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni, dhe, kur është e nevojshme, u drejtohet organeve ligjzbatuese.

Neni 19

Shqyrtimi i ankesave dhe zgjidhja e konflikteve

1. Prefekti i qarkut shqyrton ankesat e shtetasve për ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të nxjerra nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në këto raste, i kërkon organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore depozitim të aktit përkatës të prefektit i qarkut, kur një gjë e tillë nuk është bërë më parë, ose zbaton procedurat e përcaktuara në nenin 16, të këtij ligji.

2. Ankesat e shtetasve shqyrtohen nga prefekti i qarkut sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Prefekti i qarkut informohet për konfliktet që lindin ndërmjet:

- a) institucioneve të ndryshme, në nivel qarku;
- b) institucioneve dhe shtetasve, në nivel qarku.

Në këto raste, prefekti i qarkut ka detyrim të përfshihet në zgjidhjen e tyre, duke adresuar konfliktin pranë institucioneve përgjegjëse.

KREU IV

VENDIMMARRJA DHE ORGANIZIMI

Neni 20

Vendimmarrja

1. Në zbatim të përgjegjësive të tij sipas këtij ligji, prefekti i qarkut nxjerr urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për zbatim.

2. Aktet e prefektit të qarkut bëhen të zbatueshme pas marrjes së dëgjimit të subjekteve të cilave u drejtohen.

3. Në rastet kur lindin konflikte ndërmjet një ministrie ose drejtuesit të një institucioni qendror dhe prefektit të qarkut për urdhrat ose udhëzimet që ai ka nxjerrë, zgjidhja bëhet sipas përcaktimeve të nenit 9, të këtij ligji.

4. Për rastet e konflikteve të subjekteve, të përmendura në pikën 3, të këtij neni, dhe prefektit të qarkut, palës së interesuar i lind e drejta t'i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative.

Neni 21

Administrata e prefektit të qarkut dhe burimet e financimit

1. Për ushtrimin e funksioneve të përgjegjësive, prefekti i qarkut ka administratën e vet.

2. Struktura dhe organika e administratës së prefektit të qarkut miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

3. Detyrat e administratës së prefektit të qarkut, me propozim të ministrit, miratohen nga Kryeministri.

4. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të administratës së prefektit të qarkut rregullohen, në bazë të legjislationit për nëpunësin civil.

5. Marrëdhëniet e punës të punonjësve administrativë të administratës së prefektit të qarkut

rregullohen, sipas dispozitave të Kodit të Punës.

6. Administrata e prefektit të qarkut financohet nga buxheti i shtetit nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë e prefektit të qarkut.

Neni 22

NËNPREFEKTI

1. Në mbështetje të veprimtarisë së prefektit të qarkut dhe në përbërje të administratës caktohen nënprefektët. Prefekti propozon caktimin e funksionit të nënprefektit për një ose më shumë bashki, në zbatim të ligjit për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë.

1/1. **Nënprefekti zëvendëson prefektin sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.**

1/2. **Parashikimet e nenit 7 të këtij ligji për papajtueshmëritë e funksionit të prefektit zbatohen edhe për nënprefektin.**

2. Nënprefekti emërohet apo lirohet, me propozim të prefektit të qarkut, nga ministri.

3. Nënprefekti për veprimtarinë e vet, për bashkinë/bashkitë përgjigjet drejtpërdrejt te prefekti i qarkut.

4. Pranë nënprefektit funksionojnë zyrat e ankesave të qytetarëve.

Neni 23

Organi këshillues pranë prefektit të qarkut

1. Pranë prefektit të qarkut funksionon organi këshillues i tij. Përbërja e këtij organi caktohet meurdhër të prefektit të qarkut.

2. Në organin këshillues marrin pjesë kryetari i këshillit të qarkut, kryetarët e bashkive, drejtori i policisë vendore, drejtuesit e njësisë së Forcave të Armatosura për qarkun, drejtuesit e shërbimit shëndetësor, drejtuesit e drejtorisë arsimore rajonale, drejtuesit e drejtorive rajonale të tatimeve dhe doganave, drejtues të tjerë të degëve territoriale që veprojnë në qark, të caktuar nga prefekti, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile.

3. Organi këshillues mblidhet një herë në muaj për probleme të përgjegjësive të prefektit të qarkut, ku, për raste të veçanta, mund të thirren edhe specialistë të fushave përkatëse Rregullorja e funksionimit të organit këshillues miratohet nga prefekti i qarkut.

Neni 24

Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 25

Shfuqizime

Ligji nr. 8927, datë 25.7.2002, “Për prefektin”, shfuqizohet.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Miratuar në datën 18.4.2024.

Shpallur me dekretin nr. 167, datë 8.5.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.